



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KËLCYRË

Nr _____ Prot

Datë ____/____/2026

Shtojca 14.

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

[Data: 08.01.2026]

Drejtuar: **Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “2AF” shpk me NIPT L29107401J & OE “LIS KONSTRUKSION” shpk me NIPT K66613407H & OE “MELA” shpk me NIPT K62320011G**

Adresa: Berat Çorovode COROVODE Lagjja "5 Shtatori", Banese Private, Çorovode, Skrapar, ,
Adresa: Diber Bulqize Lagjja Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15,
Adresa: Tirane Tirane TIRANE Rruga Maliq Muço,Ndertesa 6,Hyrja 4,Ap 14,Njesia Bashkiake 9,Kodi Postar 1016.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

* * *

Tipi i Kontratës: Marreveshje Kuader, me nje Operator Ekonomik, ku te gjitha kushtet jane te percaktuara
Lloji i Procedurës së prokurimit: Shërbim, procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **REF- 65504-10-17-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Mirembajtje e sistemim te rrugeve qender bashki, rruge rurale te njesive vendore, si dhe mirembajtje e sistemeve te kanaleve kulluese e vaditese”

Kohëzgjatja e kontratës: **26 muaj kalendarike**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE:20.10.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike: *Buletini Nr. 63 datë 27 Tetor 2025*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “2AF” shpk me NIPT L29107401J & OE “LIS KONSTRUKSION” shpk me NIPT K66613407H & OE “MELA” shpk me NIPT K62320011G

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **23,377,620** (njetzet e tre milion e treqind e shtatedhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e njetzet) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. Operatori Ekonomik: “DRINI-1” shpk me NIPT J78716317H

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **18,811,170** (tetembedhjetë milion e tetëqind e njembehjetë mijë e njëqind e shtatedhjetë) lek pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: “DRINI-1” shpk me NIPT J78716317H

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Per arsye:

Në mbështetje të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Autoriteti/enti Kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, më datë 15.12.2025 , nëpërmjet postës elektronike (e-mail), Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i kërkoi ofertuesit të kualifikuar, i pari Operatorit Ekonomik “DRINI 1” shpk dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike (origjinal ose fotokopje e noterizuar).

- Operatori ekonomik “DRINI 1” shpk, ka depozituar, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Këlcyrë, me nr.prot hyres 2666 date 19.12.2025 dokumentacionin e kërkuar, për procedurën e prokurimit me objekt: “**Mirëmbajtje e sistemim të rrugëve qëndër bashki, rrugë rurale të njësive vendore, si dhe mirëmbajtje e sisteme të kanaleve kulluese e vaditëse**” me Nr. REF- 65504-10-17-2025.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pas depozitimit të dokumentacionit, vendosi të verifikojë dhe shqyrtojë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “DRINI 1” shpk.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar rezultoi se:

Operatori Ekonomik “DRINI 1” shpk skualifikohet sepse, nuk ka arritur të deklarojë dhe të paraqesë dokumentacion të plotë dhe të saktë për të dëshmuar plotësimin e të gjithë kriterëve të vecanta për kualifikim

Konkretisht ;

1. OE“DRINI 1” shpk, nuk ka arritur të paraqesë dokumentacion të saktë për të dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.4, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, **Kapaciteti teknik** të Dokumentave Standarte të Tenderit, ku shprehimisht është kërkuar ;

citoj: *Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:*

- Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- Inxhinier hidroteknik 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet/Topograf 1 (nje)

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.4 duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

2/1 OE “DRINI 1” shpk në përmbushje të pikës 2.3.4 të kriterëve të vecanta për kualifikim ka vetdeklaruar në shtojcën 10 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” **disponimin e një ing hidroteknik** me mbështetje nga Operatori Ekonomik “Ndregjoni” shpk .

Për këtë qëllim nga OE “Drini 1” shpk është paraqitur edhe Formulari përmbledhës i vetdeklarimit i operatorit ekonomik mbështetës si dhe akt marrëveshja nr.105 prot date 14.11.2025 mes OE Drini 1” shpk dhe OE “Ndregjoni” shpk.

Në pikën 2.3.4 të KVK-se, ing hidroteknik është kërkuar të jetë pjesë e stafit drejtues teknik dhe në licencën e shoqërisë .

Në pikën 1 të nenit 84 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta”.

Ndërsa në pikën 5 të nenit 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se ;

...5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër”.

Referuar Ligjit Nr. 120/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe Disiplinimin e Punëve të ndërtimit” ndryshuar në nenin 8, Drejtuesi Teknik, pika 1 dhe 3, citohet “1.Drejtuesi teknik është solidarisht përgjegjës me zbatuesin e punimeve për të realizuar punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik.

3. Drejtuesi i punimeve është pjesë e stafit të zbatuesit të punimeve i përcaktuar në Licencën e shoqërisë”.

Ne Vendim Nr.42, Datë 16.1.2008, Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat e

Dhënies së Licencave Profesionale të Zbatimit, Klasifikimit dhe Disiplinimit të Subjekteve Juridike, që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi, KREU IV, Drejtuesi Teknik i Shoqërisë dhe Papajtueshmëria me këtë Detyrë:

2. Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit.

Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punëmarrje tjetër publike. **Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi** dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit.

Nga interpretimii njekoheshem dhe ne harmoni me njera tjetren te dispozitave te cituara më sipër, drejtuesi teknik është pjesë e stafit kryesor të një shoqërie ndërtimi zbatimi, i përfshirë në licencën e saj, dhe ka përgjegjësi mbi zbatimin e punimeve referuar lejes së ndërtimit.

Për më tepër drejtuesi teknik, nuk mund të jetë i dypunësuar në dy shoqëri ndërtimi si drejtues teknik, ndaj Komisioni vlerëson, se ky ligj shpreh qartë përgjegjësinë e drejtuesit teknik, dhe në këtë formë në mënyrë direkte dhe të shoqërisë, e cila e ka në licencën e saj.

Ndaj marrja me mbështetje e ing. Drejtues Teknik nga nje operator tjetër sic është rasti konkret i marrjes me mbështetje Drejtuesit Teknik ing hidroteknik dhe mos paraqitja si bashkim ofertues, bie në kundërshtim me kuadrin ligjor të sipërcitua dhe perben shkak te ligjshem per skualifikim .

Nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime mbi vendosjen e këtij kriteri apo paqartësi mbi argumentimin e aplikimit te ketij kriteri ka pasur momentin procedural për të paraqitur ankesë apo kerkese per sqarim pranë AK brenda afateve të përcaktuara në LPP

Në këto kushte kur operatori ekonomik nuk ka ezauruar momentet procedurale për të kundërshtuar kriteret e vendosura ka qënë i detyruar që në fazën e vlerësimit të ofertave të paraqesë e vetdeklaroje disponimin e stafit te kerkuar me profilet perkatese te kerkuar në DST.

Ne kete rast , KVO i është referuar praktikës së vendimarrjes së KPP që ka skualifikuar në cdo rast operatoret që kanë marrë me mbështetje drejtues teknik nga nje operator tjetër.

Me konkretisht ne Vendimin e KPP-se, nr 80/2024 nr 3082/7 prot date 24.01.2024, është skualifikuar operatori ekonomik "Kevin Konstruktion" shpk sepse nga dy ing ndertimi te kerkuar si drejtues Teknik , ka patur vetem njerin ne license kurse ing tjetër e kishte marrë me mbështetje , me arsyetimin ;

....Referuar Kriterit dhe ligjit sektorial ndodhemi para faktit se operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush, pasi ka vetëm një (Inxhinier Ndërtimi)-Drejtues Teknik të pasqyruar në licencën e zbatimit të vetë shoqërisë, pra referuar legjislacionit sektorial, drejtuesi teknik është pjesë e stafit të zbatimit të punimeve dhe gjithashtu duhet të figurojë në licencën e zbatimit të shoqërisë, e cila do të kryejë këto punime. Komisioni gjykon, se arsyeja e dhënë nga ana e autoritetit kontraktor për skualifikimin e operatorit ekonomik është e drejtë.

Respektimi i parimit të qëndrueshmërisë në vendimarrje është një nga parimet kryesore që cdo organ administrativ do të duhet të zbatojë gjatë veprimtarisë së tij . Kështu në Vendimin KPP Nr. 383/2025 shprehimisht thuhet :

Komisioni thekson, se qëndrueshmëria në vendimarrje tashmë e konsoliduar prej tij, është një prej elementeve thelbësore , për arsye se ka lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin dhe respektimin e parimit të ligjshmërisë, transparencës, barazisë dhe mbi të gjitha të sigurisë juridike, të cilat KPP gjatë kryerjes së detyrave të saj zbaton me profesionalizëm, integritet dhe korrektësi, kuadrin ligjor të ...citohet prokurimeve publike.

Për këtë arsye, kriteri për disponimin e ing. hidroteknik konsiderohet i papërmbushur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2/2 Operatori ekonomik "DRINI 1" shpk, ka paraqitur shtojcën 10 Formulari përmbledhës i vetdeklarimit për të deshmuar disponimin e ing topograf z I. T me kontratë pune nr 3293 rep date 26.06.2024

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se ing I.T nuk është në profilin ing topograf sic operatori ekonomik e ka vetdeklaruar .

Ne rastin konkret jemi ne kushte e nje pasaktesie te vetdeklarim pasi ing I.T ka profilin qe nuk eshte kerkuar ne DT .

Nëse operatori ekonomik do të kishte pretendime mbi vendosjen e këtij kriteri apo paqartësi mbi argumentimin e aplikimit te ketij kriteri ka pasur momentin procedural për të paraqitur ankesë apo kerkese per sqarim pranë AK brenda afateve të përcaktuara në LPP.

Në këto kushte kur operatori ekonomik nuk ka ezauruar momentet procedurale për të kundërshtuar kriteret e vendosura ka qënë i detyrua

Jr që në fazën e vlerësimit të ofertave të paraqesë e vetdeklaroje disponimin e stafit te kerkuar me profilet perkatese te kërkuar në DST.

Për këtë arsye, kriteri per disponimin e ing topograf/gjeodet konsiderohet i papërmbushur, në përputhje me rregullat e prokurimit.

3.OE “DRINI 1” shpk, nuk ploteson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, **Kapaciteti teknik** te Dokumentave Standarte te Tenderit pika 2.3.9 , ku citoj: *Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, konkretisht: Fadrome me goma 1 copë dhe Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5 – 12 ton 1 copë.*

OE ne permbushje te kriterit te sipercituar, ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST dhe dokumentacionin provues per 1(nje) Fadrome me goma me targe AK MT 16 te siguruar me kontrate qeraje nr.4401 rep dhe 1279 kol. date 21.08.2025 me pale qiradhenese shoqerine “REN GROUP” shpk me afat 5 vjecar. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur, KVO konstatoi se certifikata e kontrollit Teknik te mjetit Fadrome me goma, ka skaduar me dt.03.10.2024 dhe Polica e sigurimit te detyrueshem mjetit ka skaduar me dt.23.03.2024. Pra OE ka paraqitur dokumentacion te skaduar per kete mjet, nderkohe ne shtojcen 10 ka deklaruar qe disponon dokumentacion te vlefshem

OE ne permbushje te kriterit te sipercituar, ka paraqitur Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10 të DST dhe dokumentacionin provues per 1(nje) Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5 – 12 ton me targe AA036FF te siguruar me kontrate qeraje nr.4401 rep dhe 1279 kol. date 21.08.2025 me pale qiradhenese shoqerine “REN GROUP” shpk me afat 5 vjecar. Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur, KVO konstatoi se certifikata e kontrollit Teknik te mjetit ka skaduar me dt.11.12.2025 dhe Polica e sigurimit te detyrueshem te mjetit ka skaduar me dt.05.12.2025. Pra OE ka paraqitur dokumentacion te skaduar per kete mjet.

Duke gene se dokumentacioni (siguracion e kontroll teknik) per keto mjete eshte i parregullt ligjerisht e keto mjete nuk mund te qarkullojne lirisht, konkludohet se operatori ekonomik nuk disponon me dokumentacion te rregullt kapacitetet e kerkuara per mjete e makineri sic jane percaktuar ne piken 2.3.9 te KVK-se, cka sjell mosplotesim te ketij kriteri.

4.OE “DRINI 1” shpk per te deshmuar plotesimin e pikes 2.3.9 te KVK-se ka paraqitur kontrate qeraje nr.6007 rep dhe 1757 kol. date 28.10.2025 me pale qiradhenese shoqerine “L.T.E. CONSTRUCTION” shpk, per mjetin Dumper me targa AOMT91. Ne nenin 3 te kesaj kontrate qeraje “Afati i kontrates” palet jane dakortesar se afati i kontrates qerase do te jete deri ne perfundim te procedures se prokurimit..

Ne kuptimin juridik qe percaktohet ne rregullat e prokurimit procedura e prokurimit nis me Urdherin e Prokurimit e mbaron me lidhjen e kontrates. Zbatimi i kontrates e realizimi i puneve nga operatori i shpallur fitues eshte nje faze krejtesisht me vete dhe e ndare nga faza e procedures se prokurimit. Zbatimi eshte nje faze tjeter qe fillon pasi te perfundoje procedura e prokurimit. Ky afat kontrate qeraje de jure e de facto konfirmon se operatori ekonomik nuk do e disponoje kete mjet gjate fazes se zbatimit te punimeve cka do te thote se operatori nuk e disponon kete mjet duke mospermblusur te plote kapacitetin e mjeteve te kerkuara ne piken 2.3.9 te KVK-se.

Në mbështetje, të nenit 92, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu X, neni 82, pika 2, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk arriti të dëshmojë se plotëson të gjitha kriteret për kualifikim e përcaktuara në dokumentet e tenderit

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “2AF” shpk me NIPT L29107401J & OE “LIS KONSTRUKSION” shpk me NIPT K66613407H & OE “MELA” shpk me NIPT K62320011G

Vlera e ofruar/ Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave: **23,377,620** (njetzet e tre milion e treqind e shtatedhjete e shtate mije e gjashteqind e njetzet) leke pa tvsh.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Totali i pikëve të marra: *Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, për këtë procedurë, është oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim.*

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Klement NDONI